

**PËRKRAHJA
E GRUAS ME
VETINICIATIVË
BIZNESORE –
ZGJIDHJA E
VETME!**



Prizren - 2017

COPYRIGHT © 2017. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Ky publikim është realizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës në bashkëpunim me OJQ-në Ec Ma Ndryshe dhe iniciativën e grave dhe vajzave të Prizrenit, FEMaktiv, ndërsa publikimi është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center. Opinonet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë analizë janë përgjegjësi e KDI-së, Ec Ma Ndryshe dhe FEMaktiv dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

▼ 04-05

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

▼ 06

METODOLOGJIA

▼ 07-10

HYRJA

▼ 11

KORNIZA LIGJORE

▼ 12-18

ANALIZA E GJENDJES AKTUALE NË PRIZREN

▼ 19

REKOMANDIME



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ndërmarrësia luan një rol mjaft të rëndësishëm në fuqizimin ekonomik të gruas, prandaj dhe gratë sipërmarrëse duhet të inkurajohen dhe të përkrahen. Mirëpo rrethanat aktuale në Kosovë në përgjithësi dhe në Prizren në veçanti tregojnë se kjo përkrahje është e kufizuar për të mos thënë mbetet në nivel simbolik.

Përderisa gratë sipërmarrëse përbëjnë mbi një të tretën (1/3) e të gjithë sipërmarrësve në mbarë botën, në Kosovë kjo përqindje është më e ulët dhe sillet diku në 13%. Në Kosovë çdo i nënti biznes është në pronësi të grave dhe sektorët në të cilët janë angazhuar gratë si pronare janë kryesisht sektorë me vlerë të ulët, duke bërë që ambienti ekonomik e biznesor i Kosovës të mbetet pak ose fare i lehtë për gratë që provojnë ndërmarrësinë. Sipas të dhënave të Qendrës për Regjistrimin e Bizneseve në kuadër të Drejtorisë së Financave në Prizren, në vitin 2016 nga 666 biznese të reja të regjistruara në Prizren në 112 prej tyre pronare janë gra, apo 16.8%. Ndërsa në 3 mujorin e parë të vitit 2017 në Qendrën e Regjistrimit të Bizneseve në Prizren janë regjistruar 31 biznese me pronare gra, nga gjithsej 224 ndërmarrjet e regjistruara, apo 13.84%.

Ndërkohë institucionet formale sikurse edhe rrethanat kulturore krijojnë pengesa shtesë për gratë, gjë që e vështirëson fillimin ose rritjen e një ndërmarrjeje afariste për to. Ky kombinim i qëndrimeve gjinore, normave dhe besimeve shoqërore rezultojnë në qasjen më të kufizuar në burimet kritike për zhvillim, siç janë arsimi, aftësitë dhe financat.

Barazia gjinore në Kosovë garantohet me legjislacion të brendshëm, duke filluar nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik e tutje me një sërë ligjesh e aktesh nënligjore, ku grave dhe burrave u përkufizohen të drejtat e njëjta. Ky legjislacion ofron edhe hapësirë për subvencionimin e projekteve të cilat promovojnë barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje por edhe fuqizimin ekonomik të tyre.

Megjithatë, kjo analizë tregon se rastet e stimulimit dhe subvencionimit të grave me vetiniciativa biznesore janë të rralla në Komunën e Prizrenit. Përkundër deklarimeve në dokumentet strategjike të pushtetit lokal, nuk ka ndonjë politikë specifike publike për këtë çështje. Një gjë të tillë e pranojnë edhe zyrtarët e lartë komunalë, të cilët theksojnë se intervenimet në rastet e pakta janë realizuar vetëm në formë projektesh në bashkëpunim me donatorët.





Përderisa Komuna e Prizrenit ka realizuar ndonjë projekt të rrallë në mbështetje simbolike të bizneseve të grave, këtë boshllëk po mundohen ta plotësojnë shoqatat e afaristëve të Prizrenit në kuadër të të cilave tashmë funksionojnë degët për gratë sipërmarrëse, ani pse me kapacitete të kufizuara. Sipas përfaqësueseve të tyre çështja themelore për përfshirjen e gruas në biznes mbetet përkrahja adekuate institucionale.

Sipas grave sipërmarrëse në Prizren ndër sfidat kryesore të tyre gjatë krijimit dhe udhëheqjes së biznesit janë: qasja në financa, qasja në informata, trajnimet, qasja në rrjetet me qëllime biznese dhe pajtimi apo harmonizimi i çështjeve të biznesit dhe familjes.

Ky hulumtim tregon se në komunën e Prizrenit pavarësisht vështirësive të shumta ka gra që tentojnë të jenë sipërmarrëse, ani pse përkrahja institucionale është e një niveli shumë simbolik. Madje institucionet nuk kanë arritur që të krijojnë as çerdhe publike e as qendra të kujdesit për të moshuarit, aspekte këto që do të kishin ndikim pozitiv drejt inkurajimit të grave që të fillojnë biznesin e tyre. Krahas institucioneve formale edhe rrethanat kulturore në këtë komunë nuk kanë qenë aq të favorshme për gratë që të

përfshihen në biznes, sidomos në zonat rurale. Në fund të analizës janë paraqitur rekomandimet për pushtetin lokal në Prizren për hartimin e zbatimin e politikave në drejtim të stimulimit dhe subvencionimit të grave me vetiniciativa biznesore.





METODOLOGJIA

Kjo analizë e shkurtër është prodhuar si rezultat i hulumtimit të realizuar nga ekipi i hulumtuesve që janë kontraktuar nga Instituti Demokratik i Kosovës. Ekipi hulumtues përgjatë dy muajve ka analizuar politikat dhe vendimmarrjen e pushtetit lokal në raport me temën e hulumtuar, sikurse edhe diskutimet e ndryshme publike, por edhe dy punëtoritë e mëparme të organizuara me komunitetin e grave në Prizren. Informatat relevante nga hulumtuesit janë grumbulluar përmes intervistave cilësore por edhe përmes qasjes në dokumente publike, por edhe në kontakt të

drejtpërdrejtë me zyrtarët/et institucionalë, komunitetin e grave sipërmarrëse dhe shoqatat e tyre, aktivistët e shoqërisë civile, gazetarët lokal, etj. Në të njëjtën kohë është analizuar korniza ligjore dhe mekanizmat ekzistues në lidhje me temën, teksa janë shqyrtuar edhe hulumtimet e publikuara nga institucionet publike dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile për çështjen në fjalë. Gjithashtu është shqyrtuar aspekti normativ si dhe veprimet në praktikë të zbatuara nga komuna për stimulimin dhe subvencionimin e grave me vetiniciativë biznesore.





HYRJA

Gratë sipërmarrëse aktualisht përbëjnë mbi një të tretën e të gjithë sipërmarrësve në mbarë botën, që administrojnë biznese si mënyrë për të siguruar të ardhura. Hyrja e tyre në botën e biznesit është ndikuar nga kushtet e rrethanat e ndryshme. Në të kaluarën, jo shumë të largët, gratë janë bërë sipërmarrëse kryesisht për shkak të përpjekjeve për t'iu shmangur varfërisë apo për të siguruar të ardhura si pasojë e humbjes së bashkëshortit, mirëpo këto nisma nuk janë trajtuar si sipërmarrje. Kjo meqë shumica e grave duhej të përkuleshin përballë përgjegjësisë që kishin brenda në familje dhe në shtëpi. Studimet e kohëve të fundit tregojnë se gratë fillojnë bizneset e tyre për një sërë arsyesh, duke filluar nga idea e një biznes-plani, pasioni për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës, mbajtja e një jete më të balancuar e deri te kthimi i vizionit në një biznes fitimprurës.

Sipas Indeksit të Ndërmarrësisë Globale Gjinore dhe Zhvillimit¹, gratë sipërmarrëse sikurse edhe burrat, ndikohen nga mjedisi i përgjithshëm i biznesit ku veprojnë. Nëse mjedisi i përgjithshëm


i biznesit është i paqëndrueshëm, nëse procedurat për fillimin dhe drejtimin e biznesit janë shumë burokratike, atëherë kjo paraqet pengesë për fillimin e punës si për burrat ashtu edhe për gratë. Mirëpo në disa raste, institucionet formale sikurse edhe rrethanat kulturore krijojnë pengesa shtesë për gratë, gjë që e vështirëson fillimin ose rritjen e një ndërmarrjeje afariste për to. Qëndrimet gjinore bashkë me normat dhe besimet shoqërore mund të ndikojnë kufizimin e qasjes së grave në edukim, aftësim dhe financa, të cilat paraqesin burime të rëndësishme për zhvillim.

Qëndrimet e shoqërisë gjithashtu luajnë një rol vendimtar në formimin e mendimeve që krijojnë "kulturën sipërmarrëse" të një vendi, që do të thotë se si popullata e përgjithshme i sheh përpjekjet sipërmarrëse, vlerësimin e rrezikut dhe pranimin e pronësisë së biznesit si një opsion të mundshëm karriere. Ky mjedis kulturor nga ana e tij ndikon në njohjen e mundësive individuale dhe gatishmërinë për të marrë rrezikun për të filluar një sipërmarrje të re.²

1 Indeksi i Ndërmarrësisë Globale Gjinore dhe Zhvillimit, Raporti Ekzekutiv, Global Entrepreneurship and Development Institute, 2013, linku: http://i.dell.com/sites/doccontent/corporate/secure/en/Documents/Gender_GEDI_Executive_Report.pdf, qasur më 30 korrik 2017

2 Po aty





Në bazë të të dhënave të Komisionit Evropian, del se gratë përbëjnë **52%** të popullsisë në BE dhe se **34.4%** prej tyre janë të vetëpunësuar, derisa **30 %** të tjera janë sipërmarrëse.

Globalizimi ka ndikuar pozitivisht në ngritjen e barazisë gjinore, kryesisht për shkak të rritjes së përqindjes së grave në tregun e punës dhe lirim të shoqërisë që rezultojnë me punën e papaguar të grave.³ Duke filluar që nga viti 1970, përqindja e grave në tregun e punës është rritur,⁴ ndërsa arsyeja e rritjes së numrit të grave në tregun e punës ka të bëjë me pagesën më të ulët në krahasim me burrat. Kësisoj bizneset janë të dominuara nga burrat. Edhe pse gratë formalisht janë në gjendje të marrin pjesë në tregun e punës, ato vazhdojnë të jenë të përjashtuara nga rrjeti social i biznesit tradicional. Në mënyrë të njëjtë edhe pse gratë arrijnë të marrin pjesë në punësimin e paguar të sektorit privat, ato vazhdojnë të jenë të përjashtuara nga ekipet e punëtorëve të kualifikuar dhe profesionistë që fitojnë më të ardhura më të larta.⁵ Gratë posedojnë dhe administrojnë mbi 30% të të gjitha bizneseve, ku tendenca është

e përqëndruar në ndërmarrjet e vogla, ndërsa vetëm 5% ose më pak, si drejtues ekzekutivë të korporatave më të mëdha në botë, janë gra.⁶ Andaj, edhe stimulimi dhe subvencionimi i grave me vetiniciativa biznesore është i domosdoshëm për ta ndryshuar situatën aktuale.

Sipas Komisionit Evropian ndonëse numri i grave është më i madh se i burrave në Evropë, megjithëkëtë gratë sipërmarrëse paraqesin vetëm një të tretën (1/3) e numrit të vetëpunësuarve në Bashkimin Evropian (BE). Në këtë drejtim thuhet se janë disa faktorë shtesë, si: *gjetja e pajtimit mes biznesit dhe familjes*, që e bëjnë ndërmarrësinë një opsion më pak atraktiv për to në krahasim me burrat. Komisioni Evropian pohon se është duke punuar me shtetet anëtare për kapërcimin e kësaj situate dhe inkurajimin e sa më shumë grave që të hapin kompanitë e

3 Bernard G. Gunter, Rolph van der Hoeven, 2004. The Social Dimension of Globalization: A Review of the Literature, vol 143, no. 1-2. 25.

4 Report Summary: Woman in the Labour Market, Two Decades of Change and Continuity, Institute for Employment Studies. Linku: <http://www.employment-studies.co.uk/report-summaries/report-summary-women-labour-market-two-decades-change-and-continuity>, qasur më 30 korrik 2017

5 Elson Diane, 1994. "Micro, Meso, Macro: Gender and Economic Analysis in the Context of Policy Reforms", In Isabell Bakker (ed.), The Strategic Silence Gender and Economic Policy, London Zed Book, pp. 33-45.

6 Report Summary: Woman in the Labour Market, Two Decades of Change and Continuity, Institute for Employment Studies. Linku: <http://www.employment-studies.co.uk/report-summaries/report-summary-women-labour-market-two-decades-change-and-continuity>, qasur më 30 korrik 2017





çdo i nënti biznes është në pronësi të grave

Kështu, një biznes i gruas punëson, mesatarisht 3.5 punëtorë; përderisa një biznes i burrit punëson dyfishin e kësaj – rreth 7 punëtorë.

tyre. Në bazë të të dhënave të Komisionit Evropian, del se gratë përbëjnë 52% të popullsisë në BE dhe se 34.4% prej tyre janë të vetëpunësuar, derisa 30 % të tjera janë sipërmarrëse. Komisioni Evropian konsideron se kreativiteti dhe potenciali ndërmarrës i grave është një burim që nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm për rritjen ekonomike dhe vendet e punës.⁷

Sipas njohësve vendor të ekonomisë, në Kosovë çdo i nënti biznes është në pronësi të grave. Sektorët në të cilët janë angazhuar gratë si pronare janë kryesisht sektorë me vlerë të ulët, dhe jo të tregtueshëm. Bizneset në pronësi të grave janë gjithashtu më të vogla krahasuar me ato në pronësi të burrave. Kështu, një biznes i gruas punëson, mesatarisht 3.5 punëtorë; përderisa një biznes i burrit punëson dyfishin e kësaj — rreth 7 punëtorë. Ky disproporcion rrjedhimisht reflektohet edhe në mundësinë e bizneseve të drejtuara nga gratë për të ofruar paga konkurrenente për punëtorët e tyre. Bizneset e grave, në mesatare, realizojnë qarkullim vjetor prej

jo më shumë se 20.000 eurosh; përderisa tek burrat kjo mesatare arrin rreth 50.000 euro në vit. Gratë dhe burrat nuk janë të barabartë as sa i përket margjinës së profitit që realizojnë në një vit. Kështu, përderisa gratë (në mesatare gjithmonë) — shënojnë profit prej 18%, ai i burrave arrin deri në 22%. Gratë janë të kufizuara edhe sa i përket diversitetit të financimit të aktiviteteve biznese. Kështu, për pjesën më të madhe të bizneseve gra (mbi 55%) kreditimi bankar vazhdon të mbetet forma më e zakonshme e financimit. Burrat në anën tjetër kanë një sërë alternativash financuese. Ata, përveçse mund të financohen nga bankat (35%), kanë alternativa financimi nga buxhetet familjare, huadhënia e miqve e të ngjashme. Pra ambienti ekonomik e biznesor i Kosovës mbetet pak ose fare i lehtë për gratë që provojnë ndërmarrësinë.⁸


Sipas të dhënave të paraqitura në një raport të UNDP-së vetëm 2% të grave në fuqinë punëtore (krahasuar me 8.2% të burrave) janë të vetëpunësuar dhe kanë nëpunës. Një nga penge-

7 European Commission> Growth...Female entrepreneurs, linku: https://ec.europa.eu/growth/smes/promoting-entrepreneurship/we-work-for/women_en, qasur me 30 korrik 2017

8 "Mbi përfshirjen e gruas në biznes", Opinion nga Lumir Abdixhiku, publikuar në Koha.net më 9 Mars 2015, linku <http://archive.koha.net/?id=31&o=580>



Bizneset e grave, në mesatare, realizojnë qarkullim vjetor prej jo më shumë se **20.000 eurosh**; përderisa tek burrat kjo mesatare arrin rreth **50.000 euro** në vit.



13%

Në Kosovë **13% të bizneseve janë në pronësi të grave**, ku prej tyre **95% janë biznese mikro apo të vogla** që numërojnë nga **1 deri në 10 punëtorë**.

sat kryesore për fillimin e një biznesi për gratë është mungesa e pronës së paluajtshme. Profili Gjinator i Kosovës thekson se Kushtetuta dhe ligji i trashëgimisë dhe ai i familjes u garantojnë grave barazi në trashëgimi, por megjithatë, gratë posedojnë vetëm 15.2% të pronave të paluajtshme në Kosovë (në vitin 2014, përfshirë tokën).⁹

Në Kosovë 13% të bizneseve janë në pronësi të grave¹⁰, ku prej tyre 95% janë biznese *mikro* apo të *vogla* që numërojnë nga 1 deri në 10 punëtorë.



Bazuar në të dhënat e Agjencisë Kosovare të Statistikave (ASK), struktura e ndërmarrjeve sipas gjinisë së pronarëve gjithashtu flet në favor të burrave. Nga 2.237 ndërmarrje të regjistruara në këtë periudhë kohore, 1774 prej tyre janë me pronarë burra apo 79.3% dhe 247 sosh me pronare gra apo 11%, derisa 216 ndërmarrje apo 9.7% janë me pronarë të përzier, gra e burra.¹¹

⁹ "Tregu i punës në funksion të grave dhe të rinjve", Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2016, UNDP

¹⁰ "Gratë dhe burrat në Kosovë 2014-2015", ASK, dhjetor 2016, linku: <http://ask.rks-gov.net/media/2581/grate-dhe-burrat-shqip-2014-2015.pdf>, qasur më 7 gusht 2017

¹¹ Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë TM2- 2017, ASK, linku: <http://ask.rks-gov.net/media/3454/repertori-statikor-tm2-2017.pdf>, qasur më 12 gusht 2017

KORNIZA LIGJORE

Legjislacioni i brendshëm i Kosovës garanton dhe mbron vlerat e barazisë gjinore duke filluar nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik e tutje me një sërë ligjesh e aktesh nënligjore, ku grave dhe burrave u përkufizohen të drejtat e njëjta.

Kushtetuta në nenin 7.2 përkufizon se: *Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore.*

Ligji për Barazi Gjinore garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për një zhvillim demokratik të shoqërisë. Sipas këtij ligji, institucionet publike marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përshpejtimin të realizimit të barazisë faktike midis burrave dhe grave në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi. Masat e veçanta mund të përfshijnë: kuotën për të arritur përfaqësimitin e barabartë të burrave dhe grave; programe për të ndihmuar dhe mbështetur rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe jetën publike; fuqizimin ekonomik dhe hapat për të përmirësuar pozitën e grave dhe burrave në fushën e punës, në arsim, në shëndetësi, kulturë dhe shpërndarjen dhe/ose rishpërndarjen e burimeve.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi i Republikës së Kosovës ndalon të gjitha format e diskriminimit në shoqëri, përfshirë këtu edhe diskriminimin në baza gjinore. Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në përputhje me parimet e këtij Ligji, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacioneve. Ndërsa Ligji i Punës, obligon punëdhënësit që të krijojnë kushte të barabarta për të dy gjinitë, por edhe të respektojnë pushimin e lehonisë. Ndërkaq Ligji për Trashëgiminë i Kosovës thekson se gratë dhe burrat kanë të drejta të barabarta në trashëgimi.

Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi në bazë të gjinisë si parime parashihen edhe në një mori ligjesh të tjera.

Në të njëjtën kohë ka edhe mekanizma ligjorë, të cilët janë të ngarkuar në zbatimin e Ligjit për barazi gjinore, ku ato të nivelit qendror janë: *Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra për Qeverisje të Mirë, të drejtat e njeriut, mundësi të barabarta dhe kundër diskriminimit, Zyrat për Barazi Gjinore nëpër ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, pastaj Institucioni i Avokatit të Popullit e Këshilli ndërmnishtrore për Barazi Gjinore.* Ndërsa në nivelin lokal ekzistojnë *Zyret për barazi gjinore në të gjitha komunat.* Programi i Kosovës për barazi gjinore paraqet një program strategjik për integrimin e barazisë gjinore në politikat dhe programet publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.¹² Hartimi i programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2018-2020 është në proces.

¹² Doracak "Legjislacioni që promovon dhe mbron barazinë gjinore në Kosovë", shoqata NORMA, linku: [http://www.norma-ks.org/repository/docs/doracak_\(2\).pdf](http://www.norma-ks.org/repository/docs/doracak_(2).pdf), qasur më 12 gusht 2017

ANALIZA E GJENDJES AKTUALE NË KOMUNËN E PRIZRENIT



Sipas të dhënave të Qendrës për Regjistrimin e Bizneseve në kuadër të Drejtorisë së Financave të Komunës së Prizrenit, në vitin 2016 nga 666 biznese të reja të regjistruara në Prizren, 112 prej tyre apo 16.8% udhëhiqen nga gratë në cilësinë e pronareve. Në pjesën dërmuese të këtyre bizne-


seve figuron se numri i punëtoreve është një (1), përderisa pesë (5) biznese kanë nga dy (2) punëtorë dhe në tetë (8) biznese të tjera ky numër sillet nga tre (3) deri në pesë (5). Vlen të përmendet se në një rast, një institucion privat i arsimimit parashkollor ka shtatë (7) punëtore.¹³



**KOMUNA
PRIZREN**
VITI 2016

Numri i përgjithshëm i
bizneseve të regjistruara

666




Pronarë burra

554

Përqindja e
bizneseve të
regjistruara me
pronarë burra

83.2%



Pronarë burra

112

Përqindja e
bizneseve të
regjistruara me
pronare gra

16.8%



Ndërsa në tremujorin e parë të vitit 2017 në Qendrën e Regjistrimit të Bizneseve në Prizren janë regjistruar 31 biznese me pronare gra, nga gjithsej 224 ndërmarrjet e regjistruara, apo 13.84%.¹⁴ Pos të dhënave për vitin 2016 e 2017, kjo qendër nuk ka mundur të ofrojë statistika më

të hollësishme edhe për vitet paraprake, sa i përket pjesëmarrjes së grave në biznes.




KOMUNA PRIZREN

TM1 2017

Numri i përgjithshëm i
bizneseve të regjistruara

224




Pronarë burra

193

Përqindja e
bizneseve të
regjistruara me
pronarë burra

86.1%



Pronarë burra

31

Përqindja e
bizneseve të
regjistruara me
pronare gra

13.8%


Ndërkaq në nivel vendi nga 2.850 biznese të regjistruara në tremujorin e parë, 2274 biznese janë me pronarë burra apo 79.8% dhe 339 biznese janë me pronare gra apo 11.9%,

derisa si ndërmarrje me pronarë të përzier janë 237 biznese apo 8.3%.¹⁵



REPUBLIKA E KOSOVËS

TM1 2017




Pronarë burra

2274

Përqindja e bizneseve të regjistruara me pronarë burra

83.2%



Pronarë burra



339

Përqindja e bizneseve të regjistruara me pronare gra

16.8%

Numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara

2850



Pronarë të përzier

237

Përqindja e bizneseve të regjistruara me pronarë të përzier

8.3%

15 Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë TM1- 2017, ASK, linku: <http://ask.rks-gov.net/media/3209/repertori-statikor-tm1-2017.pdf>, qasur më 12 gusht 2017



● ●
Komuna e Prizrenit përmes rregullores së vet për subvencione sikurse edhe Planit të Veprimit për barazi gjinore ka deklaruar angazhimin e saj për barazi gjinore dhe mundësitë e barabarta.

Komuna e Prizrenit përmes rregullores së vet për subvencione sikurse edhe Planit të Veprimit për barazi gjinore ka deklaruar angazhimin e saj për barazi gjinore dhe mundësitë e barabarta. Plani i Veprimit për barazi gjinore, si qëllim ka që të sigurojë pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në jetën sociale, ekonomike, shëndetësore e politike, të krijojë mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale, në dobi të shoqërisë. Objektiva Strategjike e Planit të Veprimit për çështjen e punësimit është fuqizimi ekonomik dhe arritja e punësimit të grave në Komunën e Prizrenit. Ndërsa rritja e numrit të grave në iniciimin dhe udhëheqjen e bizneseve të vogla, promovimi dhe zhvillimi i bizneseve të vogla janë nën objektivat e Planit të Veprimit.

Në rregulloren për subvencione të Komunës së Prizrenit, përkatësisht në pjesën e dedikuar për projektet nga fusha e të drejtave të njeriut theksohet se të drejtë subvencionimi kanë personat fizik dhe juridik, të cilët kanë nevojë dhe të cilët i plotësojnë kriteret për dhënie të subvencioneve. Sa i përket projekteve thuhet se ato duhet të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut në të gjitha fushat jetësore, përfshirë barazinë gjinore dhe mundësitë e barabarta. Ndërsa shumica e mjeteve caktohet sipas vlerësimit të prioritetit të çështjeve të cilat trajtohen dhe sipas lartësisë së mbështetjes nga ana e donatorit (nëse ka donatorë).

Megjithatë, rastet e stimulimit dhe subvencionimit të grave me vetiniciativa biznesore janë të rralla në Komunën e Prizrenit. Përkundër deklaramëve në dokumentet strategjike nuk ka ndonjë politikë specifike publike për këtë çështje. Një gjë të tillë e pranojnë edhe drejtuesit e dikasterit për Zhvillim Ekonomik, të cilët kanë pohuar se intervenimet në rastet e pakta janë realizuar në formë projektesh në bashkëpunim me donatorët. Sipas tyre në bashkëpunim me organizatën 'Help' janë mbështetur 43 biznese me pajisje apo asete në vlerë deri në 2.000 euro, ku 55 % të përfitueseve kanë qenë gra, që kryesisht merren me bizneset e floktarisë, punë dore, etj, me ç'rast, kontributi pjesëmarrës i Komunës së Prizrenit në këtë projekt ka qenë 16.000 euro.¹⁶

Edhe zyrtarët e drejtorisë së Bujqësisë pohojnë se gratë fermere janë përfituese në raste të rralla, për faktin se aplikimet nga ana e tyre janë shumë të pakta. Sipas tyre gratë në 5% të rasteve janë përfituese të subvencioneve në bujqësi, ku edhe ka raste kur ato nuk i plotësojnë në tërësi kriteret e kërkuara nga ky dikaster. Por një praktikë e tillë sipas tyre e lë të hapur mundësinë që gratë të përfitojnë subvencione në bujqësi dhe ato më pastaj të shfrytëzohen apo edhe në rastet më të rënda të keqpërdoren nga burrat.¹⁷

Ndërsa Zyra për Barazi Gjinore nuk ka ndonjë të dhënë konkrete për mbështetjen e ndonjë vetiniciative biznesore të grave, por është përmendur përkrahja që ofrohet për çdo vit për gratë afa-

¹⁶ Intervistë me Haxhi Seferqaj, drejtor i DTZHE, Komuna e Prizrenit, 18 gusht 2017

¹⁷ Intervistë me Jakup Kastratin, zyrtar në Drejtorinë e Bujqësisë, Komuna e Prizrenit, 7 gusht 2017





Gratë në 5% të rasteve janë përfituese të subvencioneve në bujqësi, ku edhe ka raste kur ato nuk i plotësojnë në tërësi kriteret e kërkuara nga ky dikaster.

riste me hapësirat ekspozuese gjatë panairëve që ekspozohen në qendrën e qytetit. Ndërkohë është theksuar se ka lehtësira për bizneset e grave ngase pas regjistrimit në dy vitet e para nuk paguajnë taksa komunale, derisa për disa biznese ka lehtësira me zbritje edhe në 50% prej taksave. Zyra për Barazi Gjinore gjatë përpilimit të rregullores komunale për taksa e ngarkesa kishte kërkuar që gratë sipërmarrëse të lirohen nga taksat, por një gjë e tillë nuk është jetësuar për shkak të drojës se burrat mund t'i regjistrojnë bizneset në emrat e grave dhe kësajoi të dëmtohet buxheti komunal.¹⁸

Në Drejtorinë e Financave (DF) e pranojnë se Komuna miraton dokumente strategjike, por nuk ka mjete financiare për t'i jetësuar ato. Sipas tyre rasti i njëjtë është edhe me Planin e Veprimit për barazi gjinore 2015-2017, që është aprovuar në Kuvend. Si shembull veçojnë se në këtë Plan parashihet që të gjitha gratë që udhëheqin biznese të lirohen nga taksat e biznesit, por që tani një gjë e tillë nuk përmendet. Defekt tjetër, në të cilin hasim në rregulloren për taksa e ngarkesa, sipas DF-së, është se si frizeret ashtu edhe sallonet e bukuri kanë taksa të njëjta komunale, që sipas tyre një gjë e tillë paraqet problem. Në të njëjtën kohë kanë konfirmuar se në DF funksionon qendra për regjistrimin e bizneseve që i jep këshilla falas grave me vetiniciativë biznesore për regjistrimin e biznesit, por se si dikaster nuk ka mjete për subvencionimin apo stimulimin e tyre.¹⁹

Përfaqësueset nga komuniteti i grave në biznes kanë deklaruar se ka pasur diskutime në drejtim të lirimit nga taksat komunale të bizneseve që udhëhiqen nga gratë, por se deri në gusht të vitit 2017 nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret rreth kësaj çështjeje.²⁰

Përderisa Komuna e Prizrenit rrallëherë ka realizuar ndonjë projekt si mbështetje simbolike të bizneseve të grave, këtë boshllëk po mundohet ta plotësojnë shoqatat e afaristëve të Prizrenit, si "Shoqata e Afaristëve dhe Zejtarëve" dhe "ESNAF", në kuadër të të cilave tashmë funksionojnë degët për gratë sipërmarrëse.

Sipas përfaqësueseve nga shoqata «ESNAF» çështja themelore për përfshirjen e gruas në biznes mbetet përkrahja adekuate institucionale. Pos kësaj, sipas tyre gratë kanë nevojë edhe për informim, për grante, por edhe për trajnim për aplikim. Dega e grave të kësaj shoqate kryesisht është e përqendruar tek gratë me biznese të vogla, duke synuar që numri i grave në biznes të rritet, sikurse edhe numri i grave të punësuar. Disa vite më parë, kjo shoqatë ka organizuar aftësimet profesionale në Turqi për gratë dhe burrat nga Prizreni, që kanë rezultuar me sukses edhe në hapjen e bizneseve të reja. Shoqata mundëson rrjetëzimin dhe shërben si pikëtakim për gratë e bizneseve të vogla me pronarët e bizneseve të mëdha, me qëllim të shitjes së produkteve dhe lidhjes së marrëveshjeve. Në të njëjtën kohë or-

18 Intervistë me Mybexhete Zhurin, Koordinatore në Zyrën për Barazi Gjinore, Komuna e Prizrenit, 18 korrik 2017

19 Intervistë me Ertan Simitçi, drejtor i Financave, Komuna e Prizrenit, 17 korrik 2017

20 M.O., pronare biznesi, diskutim gjatë debatit publik për planifikimin buxhetor komunal, më 15 gusht 2017, Komuna e Prizrenit



● ●
Zyra për Barazi
Gjinore gjatë
përpilimit të
rregullores
komunale
për taksat e
ngarkesa
kishte kërkuar
që gratë
sipërmarrëse
të lirohen nga
taksat, por një
gjë e tillë nuk
është jetësuar
për shkak
të drojës se
burrat mund
t'i regjistrojnë
bizneset në
emrat e grave
dhe kështu
të dëmtohet
buxheti
komunal.

Përfaqësueset nga komuniteti i grave në biznes kanë deklaruar se ka pasur diskutime në drejtim të lirimit nga taksat komunale të bizneseve që udhëhiqen nga gratë, por se deri në gusht të vitit 2017 nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret rreth kësaj çështjeje.

ganizohet edhe shkuarja e grave në panairë jashtë Kosovës, ku kanë arritur të krijojnë kontakte dhe madje edhe t'i shesin produktet.²¹

SHZAP si shoqatë ka një traditë 70 vjeçare të veprimit në Prizren dhe departamenti i gruas brenda kësaj shoqate mundëson kurse, trajnime, seminare, pjesëmarrje nëpër panairë të ndryshme për gratë në biznes. Është pjesë e Odës Zejtare të Koblenz-it në Gjermani dhe Zyrës Ballkanike me seli në Sofje. Zyra Ballkanike në Sofje mbledh gratë nga tërë Ballkani, ku krijohen lidhjet për zhvillim të kapaciteteve dhe aftësive në fusha të ndryshme. Departamenti i gruas në këtë shoqatë përmes panairëve mundëson bashkëpunimin mes grave, ku edhe krijohen lidhjet mes blerësve dhe shitësve.²²

Pos këtyre shoqatave, në Prizren vepron edhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug (RDA South), e cila gjatë këtij viti ka ndarë grante për 25 biznese të rajonit jugor të Kosovës, të cilat kanë përfutur

Sipas përfaqësueseve nga shoqata “ESNAF” çështja themelore për përfshirjen e gruas në biznes mbetet përkrahja adekuatë institucionale. Pos kësaj, sipas tyre gratë kanë nevojë edhe për informim, për grante, por edhe për trajnim për aplikim.

SHZAP si shoqatë ka një traditë 70 vjeçare të veprimit në Prizren dhe departamenti i gruas brenda kësaj shoqate mundëson kurse, trajnime, seminare, pjesëmarrje nëpër panairë të ndryshme për gratë në biznes.

afër çerek milion euro për zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Një e treta prej tyre kanë qenë biznese të grave sipërmarrëse. Në kuadër të kësaj skeme, të gjitha bizneset përfituese parashihet të krijojnë 75 vende të reja të rregullta të punës dhe 15 vende të reja sezonale të punës. Pos kësaj, “AZHR Jug” ofron edhe trajnime rreth sistemit të aplikimit për grantet e BE-së, procedurat e regjistrimit në *web faqet* e BE-së, hartim të biznes-planit, etj. Bazuar në kontaktet e drejtpërdrejta me gratë sipërmarrëse në Prizren del se sfidat kryesore të tyre gjatë krijimit dhe udhëheqjes së biznesit janë:

21 Intervistë me Ardiana Osmani, dega e gruas ESNAF, Prizren, 28 korrik 2017

22 Intervistë me Zejxhan Celina, departamenti i gruas SHZAP, 23 korrik 2017



● ●
 Institucionet nuk kanë arritur të krijojnë as çerdhe publike e as qendra të kujdesit për të moshuarit, aspekte këto që do të kishin pasur ndikim pozitiv drejt inkurajimit të grave që të fillojnë apo zhvillojnë biznesin e tyre

Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug (RDA South), e cila gjatë këtij viti ka ndarë grante për 25 biznese të rajonit jugor të Kosovës, të cilat kanë përfituar afër çerek milion euro për zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Një e treta prej tyre kanë qenë biznese të grave sipërmarrëse. Në kuadër të kësaj skeme, të gjitha bizneset përfituese parashihet të krijojnë 75 vende të reja të rregullta të punës dhe 15 vende të reja sezonale të punës

qasja në financa, qasja në informata, trajnimet, qasja në rrjetet me qëllime biznesore dhe pajtimi apo harmonizimi i çështjeve të biznesit dhe familjes. Ndërsa obligimet në punët e shtëpisë, për kujdesin ndaj fëmijëve, por edhe ndaj të moshuarve në familje ka bërë që një numër sosh të vonojnë vendimmarrjen për përfshirje në biznes.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se në Komunën e Prizrenit pavarësisht vështirësive të shumta ka gra që tentojnë të jenë sipërmarrëse, ani pse përkrahja institucionale është e një niveli shumë simbolik. Madje institucionet nuk kanë arritur të krijojnë as çerdhe publike e as qendra të kujdesit për të moshuarit, aspekte këto që do të kishin pasur ndikim pozitiv drejt inkurajimit të grave që të fillojnë apo zhvillojnë biznesin e tyre. Krahas institucioneve formale, edhe rrethanat kulturore në këtë komunë nuk kanë qenë aq të favorshme për

Bazuar në kontaktet e drejtpërdrejta me gratë sipërmarrëse në Prizren del se sfidat kryesore të tyre gjatë krijimit dhe udhëheqjes së biznesit janë: qasja në financa, qasja në informata, trajnimet, qasja në rrjetet me qëllime biznesore dhe pajtimi apo harmonizimi i çështjeve të biznesit dhe familjes. Ndërsa obligimet në punët e shtëpisë, për kujdesin ndaj fëmijëve, por edhe ndaj të moshuarve në familje ka bërë që një numër sosh të vonojnë vendimmarrjen për përfshirje në biznes.

përfshirjen e grave në biznes, sidomos në zonat rurale. Ndërmarrësia luan një rol të rëndësishëm në fuqizimin e gruas, prandaj dhe gratë sipërmarrëse duhet të inkurajohen dhe të përkrahen, sepse një gjë e tillë i mundëson shoqërisë zhvillimin ekonomik dhe shfrytëzimin e potencialit të plotë njerëzor.

Deri më tani, Komuna e Prizrenit, me mënyrën e saj të qeverisjes dhe politikbërjes ka dëshmuar se nuk e njeh potencialin e pjesëmarrjes aktive të grave në aktivitetet ekonomike dhe ndryshimet që ky komunitet mund t'i sjellë për zhvillimin ekonomik lokal. Përkrahja dhe burimet e ofruara për gratë kanë qenë të një niveli minimal drejt përfshirjes më aktive të grave në ekonomi, duke ndikuar shumë pak për ndryshimin e kësaj gjendjeje.



REKOMANDIMET

1

Komuna e Prizrenit duhet të zhvillojë politika specifike për mbështetjen e grave sipërmarrëse, për të kapitalizuar potencialin e tyre në ekonomi, në mënyrë që të arrihet barazia gjinore në mes të grave dhe burrave;

2

Komuna duhet të krijojë një fond stimulues për gratë fillestare në biznes, si dhe të ndajë buxhet nga kategoria e subvencioneve për stimulimin e grave sipërmarrëse;

3

Komuna me partnerë nga niveli qendror dhe komuniteti i donatorëve duhet të organizojë fushata për promovimin e ndërmarrësisë së grave, si dhe të punës së grave;

4

Komuna duhet të promovojë bizneset ekzistuese të grave përmes përkrahjes së projekteve të tyre;

5

Komuna duhet të ndërtojë partneritet me shoqatat e grave, sidomos ato të afaristeve, për avancimin e interesave të grave sipërmarrëse dhe këshillimin e grave fillestare në biznes;

6

Duhet të iniciohet rishikimi i politikës së taksave komunale në raport me bizneset në pronësi të grave;

7

Komuna t'i jep në shfrytëzim pronat e veta (lokalet) për gratë në biznes me një qira simbolike - të përballueshme;

8

Komuna të sigurojë një hapësirë për shitje, ku gratë mund t'i ekspozojnë produktet e tyre artizanale.

This publication is part of the project "United women for a gender friendly political, economic and social governance", implemented by (KDI, Ec ma Ndryshe and FEMaktiv, financed by Olof Palme International Center supported by Swedish Government. Content of this publication reflects author's opinions and not necessarily Olof Palme International Center opinions.

